



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 01, datë 28.12.2020


PËR
MIRATIMIN E PLANEVE TË DETAJUARA PËR ZONAT E RËNDËSISË
KOMBËTARE NË BREGDET "BAKS-RRJOLL DHE RANA E HEDHUN-PORT
SHËNGJIN"

Në mbështetje të neneve 7, 9, 18 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, Vendimit të KKT Nr. 3 datë 23.10.2019 "Për miratimin e nismave për hartimin e Planeve të Detajuara për Zonat e Rëndësisë Kombëtare në Bregdet: Baks-Rrjoll, Rana e Hedhun-Port Shëngjin, Grykë-Derdhja e Ishmit, Tale dhe Spille", me kërkesë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planeve të Detajuara për Zonat e Rëndësisë Kombëtare në Bregdet: Baks-Rrjoll dhe Rana e Hedhun-Port Shëngjin, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtme:
 - a) *Plani i Detajuar i Zhvillimit;*
 - b) *Rregullorja e Detajuar e Planit;*
 - c) *Hartat shoqëruese.*
2. Gjatë hartimit të planeve të tjera sektoriale, planeve të detajuara për zona të rëndësisë kombëtare, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore, projekteve strategjike dhe pilot të zhvillimit, si dhe të tjera të ngjashme me to, autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit në nivel qendror, qarku dhe atë vendor, duhet të bazohen në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Planet e Detajuara për Zonat Rëndësisë Kombëtare në Bregdet: Baks-Rrjoll dhe Rana e Hedhun-Port Shëngjin.
3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të planifikimit, që hartohen nga autoritetet përgjegjëse të planifikimit të territorit, me përcaktimet e Planeve të Detajuara për Zonat Rëndësisë Kombëtare në Bregdet: Baks-Rrjoll dhe Rana e Hedhun-Port Shëngjin.





4. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Bashkitë Shkodër dhe Lezhë për zbatimin e këtij Vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDLIR DALLA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEBIA TOTA

